



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E THESARIT
Drejtoria e Kontabilitetit

Nr. 9954 Prot.

Tirane 28 /12 / 2006

U D H E Z I M

Nr. 14 date 28 / 12 / 2006

PER PERGATITJEN DHE RAPORTIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE
VJETORE TE VITIT 2006 PER INSTITUCIONET QENDRORE, ORGANET E
PUSHTETIT VENDOR DHE NJESIVE QE VAREN PREJ TYRE SI DHE TE
NJESIVE TE MENAXHIMIT / ZBATIMIT TE PROJEKTEVE E MARRVESHJEVE
ME DONATORE TE HUAJ

Ne zbatim te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 248 date 10.04.1998, te ndryshuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr.25, date 20.01.2001, "Per Miratimin e Planit Kontabel Publik te Organeve te Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetore Qendrore e Lokale si dhe njesive qe varen prej Tyre", me propozim te Drejtorise se Kontabilitetit ne Drejtorine e Pergjithshme te Thesarit per pregatitjen dhe raportimin e Pasqyrave Financiare te vitit 2006 ;

U D H E Z O J :

Procedurat per raportimin e Pasqyrave financiare te vitit 2006, procedurat e pregatitjes dhe mbylljes se llogarive, shpjegimet lidhur me permbajtjen e plotesimin e pasqyrave financiare dhe disa vecori per pregatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare te njesive te menaxhimit / zbatimit te projekteve e marreveshjeve me donatore te huaj jane si me poshte :

I. PROCEDURAT E RAPORTIMIT TE PASQYRAVE FINANCIARE PER
VITIN 2006

1. Pasqyrat Financiare vjetore individuale te vitit 2006 per te gjitha Institucionet Qendrore, Vendore dhe te njesive te menaxhimit / zbatimit te projekteve me donatore te huaj si dhe njesive qe varen prej tyre te pregatiten dhe raportohen sipas formatit te miratuar nga Ministri i Financave qe gjendet ngjitur ketij udhezimi. Perberesit dhe formatet e Pasqyrave Financiare jane ;

- Bilanci kontabel (aktivi dhe pasivi sipas formateve nr. 1 e nr.2).
- Pasqyrat e shpenzimeve dhe te ardhurave te ushtrimit(Formatet nr. 1/1 e nr.1/2).
- Pasqyrat e shpenzimeve dhe te ardhurave qe lidhen me investimet (Formatet nr. 2/1 e nr. 2/2).
- Pasqyra mbi levizjen e disponibiliteteve (Formati nr. 3).
- Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet ne Aktivet e Qendrushme si dhe amortizimin e tyre (Formatet nr. 4 e nr. 5).
- Pasqyra e levizjes se fondeve(Formati nr. 6).
- Pasqyre mbi numrin e punonjesve dhe fondin e pagave (Formati nr. 7).
- Pytesor me te dhena e shenime shpjeguese per hartimin e Pasqyrave Financiare (Formati nr.8).

2. Institucionet buxhetore nacionale jane te detyruar te depozitojne llogarine vjetore te vitit 2006 brenda dates 28.02.2007. Depozitimi behet nje kopje ne Degen e Thesarit te Rrethit perkates dhe, pas marrjes se konfirmimit nga kjo e fundit, nje kopje dergohet ne Ministrine apo Institucionin Qendror perkates sipas vartesis dhe nje kopje tjeter ne zyren e statistikes se rrethit.

3. Institucionet e Qeverisjes Vendore jane te detyruar te depozitojne pasqyrat Financiare vjetore te vitit 2006 brenda dates 28.02.2007. Depozitimi, nje kopje ne Degen e Thesarit te rrethit perkates, dhe pas pranimit nga kjo dege nje kopje dergohet ne prefektore dhe ne zyren e statistikes se rrethit.

4. Njesite e menaxhimit / zbatimit te projekteve e marrveshjeve me donatore te huaj detyrohen te depozitojne brenda dates 15.03.2007 nje kopje te Pasqyrave Financiare prane Ministrise apo institucionit publik qe menaxhon projektin/organ i vartesis, nje kopje prane donatorit/reve perkates dhe , pas miratimit nga Deget perkatese te Thesarit kur vepron me skemen e thesarit., nje kopje ne Drejtorine e Kontabilitetit prane Ministrise se Financave.

5. Ministrite dhe Institucionet e tjera Qendore , pervec pasqyrave financiare individuale, hartojne permbledhesen e Pasqyrave Financiare vjetore 2006 per te gjitha institucionet e vartesis se tyre dhe e depozitojne ate ne Drejtorine e Kontabilitetit ne Ministrine e Financave brenda dates 20 Prill 2007. Ministrite dhe Institucionet e tjera qendrore (te cilat nuk kane njesi shpenzuese me kontabilitet me vehte ne vartesi) brenda dates 28.02.2007 e depozitojne Pasqyrat Financiare te tyre nje kopje ne Degen e Thesarit dhe pas konfirmimit nga kjo e fundit dergohet nje kopje ne Drejtorine e Kontabilitetit prane Ministrise se Financave dhe nje kopje ne zyren e statistikes.

6. Deget e Thesarit ne rrethe hartojne permbledhesen e Pasqyrave Financiare vjetore 2006 per te gjitha institucionet vendore te juridiksionit te tyre dhe e depozitojne ate brenda dates 20 Prill 2007 ne Drejtorine e Kontabilitetit prane Ministrise se Financave, ne prefektoren perkatese,ne qarkun perkates dhe ne Ministrine e Brendeshme.

7. Drejtoria e Thesarit dhe ajo e Borxhit ne Ministrine e Financave hartojne, permbledhin dhe depozitojne ne Drejtorine e Kontabilitetit brenda dates 20 prill 2007 raportet lidhur me borxhin e brendshem e te jashtem te Qeverise te listuar sipas inventarit perkates. Ky informacion te jete per vitin ushtrimor dhe progresiv. Raport i posacem te pergatitet edhe per levizjet e stokut te borxhit dhe koston e tij per vitin e fundit buxhetor. Drejtoria e Thesarit te pergatise edhe raportin e levizjeve dhe te gjendjes se stokut te llogarise Depozite e Qeverise, te llogarive te tjera speciale te celura per llogari te Shtetit Shqiptar ne Banken e Shqiperise, te asetave financiare, te rezerves valutore te Qeverise e te tjere elemente pasurore qe duhet te perfshihen ne bilancin e Shtetit Shqiptar.

8. Drejtoria e Kontabilitetit ne Ministrine e Financave, mbi bazen e informacionit te depozituar, harton brenda dates 15 Qershor 2007 permbledheset e llogarive vjetore 2006 ne keto nivele;

- Per Ministrite dhe Institucionet e tjera qendrore
- Per ISSH dhe ISKSH
- Per njesite e menaxhimit / zbatimit te projekteve e marrveshjeve me donatore te huaj
- Per organet e Qeverisjes Vendore

9. Drejtoria e Kontabilitetit ne Ministrine e Financave mbi bazen e te gjitha informacionit te hartuar e depozituar ben konsolidimin e pasqyrave financiare te vitit 2006 ne nivel qendror e lokal dhe i raporton ato brenda dates 15 Korrik 2007.

10. Per mos depozitim ne afatet e permendura te informacionit (pika 2 deri ne 6 si me siper) per personat pergjegjes zbatohen sanksionet e ligjit per kontabilitetin, per buxhetin, kodit te punes dhe ligjit per punonjsit e sherbimit civil.

II. PROCEDURAT E PREGATITJES DHE MBYLLJES SE LLOGARIVE VJETORE TE VITIT 2006

1. Procedura te pergjithshme

- **Institucionet individuale** (njesite shpenzuse me kontabilitet me vehte) te Qeverisjes Qendrore dhe Vendore kryejne inventarizimin e elementeve te pasurise, konform kriterave te percaktuara ne Ligjin "Per Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", dhe akteve te tjera ligjoreduke perfshire aktivet afat gjata, inventaret si dhe te drejtat e detyrimet ndaj te treteve. Mbi bazen e tyre behen sistemimet e diferencave per llogari te vitit kontabel qe mbyllet.
- **Kerkesat per arketim mbi debitoret si dhe detyrimet** te paraqiten ne bilanc me vleren e tyre ne kontabilitet. Per veprimet ne monedha te huaja konvertimi ne leke te behet me kursin e kembimit e dates se fundit te vitit te shpallur nga Banka e Shqiperise. Diferencat e lindura nga vleresimi per gjendjen e te drejtatve dhe detyrimeve ne monedha te huaja te kontabilizohen me kunderparti sipas rastit llogarite 477 e 478 "Diferenca konvertimi". Efektet nga konvertimi i monedhave te huaja per veprimet e

kryera gjate vitit per mardheniet lidhur me te drejtat e detyrimet te kalojne sipas rastit ne llogarite 656"Shpenzime nga kembimet valutore" apo 766 "Te ardhura nga kembimet valutore".

- **Gjendjet ne valute te huaj prane arkes apo bankave** te konvertohen ne leke me kursin e fundit te vitit te shpalluar nga Banka e Shqiperise duke i kontabilizuar keto diferenca sipas rastit me kunderparti llogarite 656"Shpenzime nga kembimet valutore" apo 766"te ardhura nga kembimet valutore".
- **Amortizimi vjetor** te llogaritet dhe te kontabilizohet sipas normave te percaktuara ne VKM nr. 401 te vitit 1989, ndersa per paisjet informatike dhe elektronike te perdoret ligji aktual fiskal "Per Tatimin Mbi te Ardhurat" me norma amortizimi 25% dhe aplikimi te behet mbi vleren e mbetur(kosto ose vlera kontabel minus amortizimin e akumuluar te llogaritur, shumzuar me 25%). Ne baze te ketyre dispozitave keto norma te jene ;
 - 1 % per ndertesat e konstruksionet
 - 3 % per Inventarin ekonomik
 - 25 % per paisjet informatike, kompjuterike e elektronike
 - 5.8 % per makinerite e paisjet operacionale, instrumenta e vegla
 - 13.8 % per Mjetet e transportit

2. Funkcionimi i disa llogarive specifike te planit kontabel publik

Ne pershtatje me vecorite ne veprimtarine e institucioneve publike duhet te kene funksionuar edhe disa llogari kontabile specifike skemat e te cilave jane si me poshte ;

- **Llogaria 1011"Shitesa te fondit baze"** e cila merr ne kredi:
 - Vleren e aktiveve te blera apo te krijuara ne institucion (per aktivet e marra ne dorzim) me kunderparti debitin e llogarive perkatese te burimeve (105,106 dhe 115).
 - Mbetjen kreditore te llogarise 116"Te ardhura nga shitja e AQ" me kunderparti debitin e saj.
 - Ndikimin pozitiv te ndryshimit te gjendjeve te inventarit ne fund te ushtrimit me kunderparti debitin e llogarise 8423"Transferim i ndryshimit te gjendjeve"
 - Shumat qe rezultojne teprice inventari ne debi te llogarive perkatese te grupeve 20 e 21 te aktiveve te qendrushme.
- **Llogaria 1012"Paksime te fondeve baze"** qe merr ne debi:
 - Ndikimin negativ te ndryshimit te gjendjeve te inventarit ne fund te ushtrimit me kunderparti kreditin e llogarise 841"Transferimi i ndryshimit te gjendjeve".
 - Mbetjen debitore ne fund te vitit te llogarise 116"te ardhura nga shitja e AQ" ne kredi te saj.
 - Shumat qe rezultojne mungese inventari ne kredi te llogarive perkatese te grupeve 20 e 21 te aktiveve te qendrushme.

- **Llogaria 1013**”Konsumi i aktiveve te qendrushme” qe merr ne debi amortizimin vjetor te aktiveve te qendrushme me kunderparti kreditin e llogarise 219”Amortizimi i aktiveve te qendrushme”
- **Llogaria 1014**”Paksime fondi nga shitja e aktiveve te qendrushme” merr ne debi vleren kontabel neto per aktivet qe shiten nga institucioni me kunderparti llogarite perkatese te grupit 20 e 21 te AQ pas pakesimit te tyre per amortizimin e akumuluar(209 e 219).
- **Llogaria 1015**”Paksime fondi nga nxjerrjet jashte perdorimit te AQ” qe merr ne debi vleren kontabel neto per AQ qe dalin jashte perdorimit me kunderparti llogarite perkatese te grupit 20 e 21 te AQ dhe amortizimin e tyre (209 e 219).
- **Llogaria 1016**”Pasim fondi nga transfertat brenda e jashte sistemit” qe merr ne debi vleren kontabel neto per transferimin pa pagese te aktive te qendrushme qe ben institucioni tek te tretet me kunderparti llogarite perkatese te grupit 20 e 21 te AQ dhe amortizimin e tyre(209 e 219).
- **Llogarite 1050, 1051 e 1052**, qe perfaqsojne grante kapitale dhe kontribute te te treteve per investime marrin ne kredi vleren e ketyre granteve me kunderparti debitin e llogarise 476”Te ardhura te caktuara per t’u perdorur” ose te llogarise 520 “Disponibilitete ne thesar”, kur nuk tranzitohen veprimet nga llogaria 476.
- **Llogarite 1060 e 1061**, qe perfaqsojne grante kapitale e kontribute nga qeveri e institucione nderkombtare per investime, qe marrin ne kredi vleren e ketyre granteve me kunderparti debitin llogarise 512 “Llogari ne banke” apo llogarise 520 “Disponibilitete ne thesar”.
- **Llogarite 1059**”Grante te brendeshme kapitale ne natyre” **dhe 1069** ”Grante te huaja kapitale ne natyre” marrin ne kredi vleren e aktiveve te dhuruara nga transferimet e brendeshme apo donatore te huaj(te marra ne dorzim dhe te bera hyrje ne institucion) ne debi te llogarive perkatese te aktiveve.
- **Llogaria 107**”Aktive te qendrushme te caktuara ne perdorim” merr ne kredi vleren neto te aktiveve te qendrushme qe institucioni merr ne perdorim nga te tretet me kunderparti debitin e llogarive perkatese te grupit 21 te AQ.
- **Llogaria 116**”Te ardhura nga shitja e aktiveve te qendrushme” qe merr;
 - Ne kredi operacionet qe rrjedhin nga shitja e AAGj(cmim shitjeje) me kunderparti llogarite e te treteve ose llogarite financiare dhe mbetjen debitore te saj ne fund vitit me kunder parti llogarine 1011”Shtesa te fondit baze”.
 - Ne debi vleren kontabel neto te AAGj te shitura ne kredi te llogarive perkatese te aktiveve te qendrushme; shumen (pjesen) e te ardhurave qe derdhen ne buxhet ne kredi te llogarise 520

“Disponibilitete ne thesar” dhe ne fund te vitit mbetjen e saj kreditore me kunderparti llogarine 1012 “Paksime te fondit baze”

- **Llogarite 145**”Grante te brendshme kapitale per pjesmarrje ne investime per te trete” **dhe 146**”Grante te huaja kapitale per pjesmarrje per investime per te trete” pasqyrojne ne kredi financimet per investime te pa perfunduara (te pa dorzuara) qe kryejne keta donatore per te trete me kunderparti respektivisht debitin e llogarive 105”Grante te brendshme kapitale dhe 106”Grante te huaja kapitale” ose 476 “te ardhura te caktuara per tu perdorur”.
Keto llogari (145 e 146) kreditohen edhe ne debi te llogarise 520”Disponibilitete ne thesar” ne rast se grantet jane te trashegushme.
Keto llogari(145 e 146) debitohen per vleren e AQ te perfunduara e te dorzuara te treteve me kunderparti kreditin e llogarive te grupit 23”Aktive te qendrushme ne proces”.
- **Llogaria 28 “Caktime”**, si llogari me teprice debitore, mer ne debi shumen e aktiveve te qendrushme (me vleren neto) qe u jepen te treteve me kunderparti kreditin e llogarive perkatese te grupit 21(per vleren historike) dhe debitimin e llogarise 219 per amortizimin e akumuluar.
- **Grupi i llogarive 45”Mardhenie me institucionet brenda dhe jashte sistemit”** perfaqeson specifikat qe shoqerojne mardheniet e institucioneve me njera tjetren dhe me te tjere te trete per xhirimet materiale ne natyre. Nga pikpamja e kontabilitetit institucionet e lidhura te perdorin skemen si me poshte ;
 - Institucioni dhenes kryen blerjet mbi bazen e fondeve te akorduara sipas skemes se zakonshme te buxhetimit duke menaxhuar te gjitha fondet dhe, pervec veprimeve qe lidhen me blerjen e operacionet e tjera buxhetore, ben hyrje materialet e blera.(debi llogarite e klases 3 ne kredi te llogarise 63”ndryshim i gjendjeve”).
 - Institucioni dhenes per daljet pa pagese qe u ben njesive vartese apo te treteve krediton llogarite perkatese te klases 3 me kunderparti debitin e llogarive te grupit 45”Mardhenie me institucionet brenda dhe jashte sistemit”.
 - Institucioni dhenes mbyll llogarine 45 pas marrjes se konfirmimit nga institucioni perfitues(debi llogaria 63 “Ndryshimi i gjendjeve” ne kredi te grupit 45” Mardhenie me institucionet brenda dhe jashte sistemit”).
 - Institucioni marres i ketyre vlerave i ben hyrje ato duke debituar llogarite perkatese te klases 3 me kunderparti kreditimin e llogarise se grupit 45”Mardhenie me institucionet brenda e jashte sistemit.
 - Institucioni marres llogarine 45”mardhenie me institucionet brenda dhe jasht sistemit” e mbyll me dergimin e konfirmimit ne institucionin dhenes duke debituar kete llogari ne kredi te llogarise 63”Ndryshimi i gjendjeve”.
 - Llogaria 45”mardhenie me institucionet brenda dhe jashte sistemit” ne fund te periudhes ushtrimor duhet te rakordohet dhe, si rregull, duhet te jete e mbyllur.

- **Funksionimi i disa llogarive specifike te klases 7"Te ardhura"**
 - **Llogaria 7204**"Te ardhura per pjesmarrjet te institucionit ne tatimet e taksat nacionale" perdoret nga ato institucione publike qe ushtrojne veprimtari si agjent tatimore. Ato pasqyrojne ne kredi te kesaj llogarie pjesen qe perfitojne nga te ardhurat e arketuara sipas perqindjeve te caktuara ne akte ligjore e nenligjore ne fuqi me kunderparti debitin e llogarive te te drejtave apo llogarise 520"Disponibilitete ne thesar".
 - **Llogaria 7205** "Financim shtese nga te ardhurat e krijuara brenda sistemit" perdoret ne ato institucione qe realizojne te ardhura gjate vitit por nuk kane kopetence perdorimin direkt te tyre.Per perdorim te tyre ato presin autorizimin nga qendra e institucionit. Kjo e fundit kryen shperndarjen ne institucionet e vartese. Qendra dhe njesite vartese paraqesin ne kredi te kesaj llogarie (7205) vetem shtesen (domethene diferencen pozitive midis shumes se autorizimit per shpenzim me shumen e te ardhurave te realizuara nga institucioni) me kunderparti llogarive 520"Disponibilitete ne thesar". Neqoftese diferenca eshte negative nuk behet asnje regjistrim ne librat e kontabilitetit.
 - **Llogaria 7206** "Financim i pritshem nga buxheti" pasqyron si kunderparti ato lloj shpenzimesh te konstatuara nga institucioni ne vitin ushtrimor qe perballohen me fondet e buxhetit te vitit te mepasshem (si rregull hyjne pagat e 15/diteshit te dyte te dhjetorit, sigurimet shoqerore, shendetsore dhe tatimet e muajit Dhjetor e ndonje shpenzim tjeter). Mbi bazen e ketij informacioni, qe eshte konstatuar ne kontabilitet ne llogarite e detyrimeve, institucioni ne fund te periudhes ushtrimore ben veprimin kontabel ne debi te llogarise 4342"Mardhenie me shtetin debitor" dhe ne kredi te llogarise 7206 "Financim i pritshem nga buxheti".
- **Llogarite qe lidhen me operacionet e korigjimit te rezultatit** jane specifike per institucione buxhetore pasi per to nuk ka kuptim ndikimi i operacioneve buxhetore ne rezultat, prevec rasteve kur ato trashegojne me dispozita ligjore per vitin e ardhshem te ardhura dytesore apo grante. Funksionimi i ketyre llogarive paraqitet si me poshte;
 - **Llogaria 828**"Te ardhura te anuluar nga vitet e meparshme" vepron ne ato rate kur sipas procedurave ligjore te kontrolluara anulohet nje e drejte e konstatuar ne vitet e kaluara. Per kete institucioni debiton llogarive e mesiperme operacionale ne kredi te llogarise 468"Debitore te ndryshem" apo ndonje llogari tjeter ku eshte pasqyruar e drejta ne fillim.
 - **Llogaria 829**"Shpenzime te anuluar nga vitet e meparshme" vepron ne ato rate kur sipas procedurave ligjore te kontrolluara anulohet nje detyrim i konstatuar ne vitet e kaluara. Per kete

institucioni krediton llogarine e mesiperme operacionale ne debi te llogarise 467"Kreditore te ndryshem" apo ndonje llogari tjetër ku ka gene evidentuar detyrimi.

- **Llogaria 831**"Caktim te ardhurash te funksionimit per investime" perfaqeson ate mase te ardhurash te realizuar gjate vitit dhe qe caktohet nga organet kopetente per t'u perdorur per shpenzime kapitale. Per kete institucioni ben veprimin kontabel duke debituar llogarine e mesiperme ne kredi te llogarise 115"Te ardhura nga funksionimi per investime".
- **Llogaria 841**"Transferimi i ndryshimit te gjendjeve" perfaqeson efektin per transferim te ndryshimit te gjendjeve te inventarit (klasa 3). Kur diferenca e klases 3 midis fundit te ushtrimit dhe fillimit te ushtrimit del negative(paksim gjendje inventari) atehere per te mospatur efekt ne rezultat (krahas veprimeve te evidentuara ne klases 3 me kunderparti llogarine 63) behet transferimi duke kredituar llogarine 841"transferimi i ndryshimit te gjendjeve" ne debi te llogarise 1012"Pasime te fondit baze".
- **Llogaria 8420**"Transferim per derdhje te te ardhurave ne buxhet" perfaqeson ate pjese te te ardhurave qe sipas dispozitave ligjore arketohet ne institucion por shuma i perket buxhetit te shtetit. Per kete, krahas kontabilizimit te arketimit te te ardhurave, per te mos ndikuar ne rezultat, institucioni ben veprimin kontabel ne debi te llogarise se mesiperme me kunderparti kreditin e llogarise 4341"Te tjera operacione me shtetin kreditor".
- **Llogaria 8421**"Transferim ne buxhet te te ardhurave te pa perdorura" perfaqeson ate pjese te te ardhurave qe sipas dispozitave ligjore arketohet ne institucion, i perket institucionit per t'u perdorur deri ne fund te vitit por nuk e ka perdorur.Ne kete rast kjo e ardhur i perket buxhetit te shtetit dhe per kete, krahas kontabilizimit qe eshte bere per arketimin e te ardhurave (per te mos ndikuar ne rezultat) institucioni ben veprimin kontabel ne debi te llogarise se mesiperme me kunderparti kreditin e llogarise 4341"Te tjera operacione me shtetin kreditor".
- **Llogaria 8422**"Transferim te te ardhurave brenda sistemit" evidenton transferimin e te ardhurave nga institucioni i vartesise per qendren qe perben diferencen midis te ardhurave te realizuara dhe te ardhurave te autorizuar nga qendra per shpenzim. Per kete qellim ne fund te periudhes institucioni ben veprimin kontabel ne debi te llogarise se mesiperme te transferimit me kunderparti kreditin e llogarise 520"Disponibilitete ne thesar".
- **Llogaria 8423**"Transferimi i ndryshimit te gjendjeve" perfaqeson efektin per transferim te ndryshimit te gjendjeve te inventarit (klasa 3). Kur diferenca e klases 3 midis fundit te ushtrimit dhe fillimit te ushtrimit del pozitive (shtim gjendje inventari) atehere per

te mospatur efekt ne rezultat (krahas veprimeve te evidentuara ne klasen 3 me kunderparti llogarine 63) behet transferimi duke debituar llogarine 8423"transferimi i ndryshimit te gjendjeve" ne kredi te llogarise 1011"Shtesa te fondit baze".

- **Llogaria 8424**"Transferime per debitore te konstatuar e te ngjashem" perfaqeson ato transferime te ardhurash te konstatuara per ne buxhet gjate vitit ushtrimor por qe nuk jane arketuar ne llogarite financiare te klases 5.

Per kete institucioni (krahas evidentimit te bere per konstatimin e tyre si te ardhura, debi llogaria 468 "Debitore te ndryshem" me kunderparti kreditin e llogarive perkatese te klases 7) duhet qe ne fund te periudhes te konstatoje nje detyrim per shtetin duke debituar llogarine 8424"Transferime per debitore te konstatuar e te ngjashem" me kunderparti kreditin e llogarise 4341"Mardhenie me shtetin kreditor".

3. Procedurat e rakordimit dhe te mbylljes se llogarive

Pas regjistrimit te veprimeve kronologjike ne ditaret e kontabilitetit dhe te saktesimeve te mesiperme, ne fund te periudhes institucioni harton nje bilanc paraprak verifikues dhe me pas vepron me procedurat e rakordimit, sistemimit te diferencave dhe me veprimet e mbylljes se llogarive deri ne nxjerrjen e pasqyrave financiare perfundimtare. Per kete te ndiqet kjo radhe;

▪ **Procedura rakordimi :**

- **Rakordimi i inventarit fizik te pasurise dhe i te drejtave e detyrimeve** me informacionin qe jep evidenca kontabile duke bere sistemimin e diferencave eventuale.
- **Rakordimi ne se ne debi te llogarise 520**"Disponibilitete ne thesar" jane te kontabilizuara te gjitha autorizimet buxhetore si dhe shtesat apo paksimet e bera gjate vitit me kunderparti llogarine 476"te ardhura te caktuara per t'u perdorur".
- **Rakordohet ne se ne debi te llogarise 520** jane evidentuar te gjitha te ardhurat apo arketimet e tjera mbi bazen e situacionit te te ardhurave te konfirmuar nga dega e thesarit.
- **Rakordohet ne se ne kredi te llogarise 520** jane te evidentuara saktesisht te gjitha pagesat mbi bazen e situacionit te shpenzimeve te konfirmuara nga dega e thesarit.
- **Rakordohet llogaria 4342**"Mardhenie me shtetin debitor" per pagesat e bera per detyrimet e nje viti me pare. Krahas pagese qe eshte bere (debi klasa 4 per detyrimet ne kredi 520"Disponibilitete ne thesar"e bere gjate vitit) te verifikohet dhe ne rast se nuk eshte kryer te behet veprimi(qe eshte paralel) debi llogaria 476"Te ardhura te caktuara per t'u perdorur" ne kredi te 4342"mardhenie me shtetin debitor".
- **Rakordohen, llogariten dhe regjistrihen** ne llogarine 4342"Mardhenie me shtetin debitor" detyrimet buxhetore, te lindura por te pa likujduara dhe qe parashikohen te likujdohen me fondet buxhetore te vitit te

ardhshem, me veprimin kontabel debi llogaria e mesiperme 4342 ne kredi te llogarise 7206 "Financim i pritshem nga buxheti"

- **Rakordohet teprica e llogarise 4341** "Mardhenie me shtetin kreditor"ne se jane kryer veprimet qe lidhen me transferimet e te ardhurave ne buxhet (debi llogarite 8420, 8421 e 8424 ne kredi te llogarise 4341). Ne se nuk jane kryer te behet veprimi duke debituar llogarite e mesiperme te klases 8 ne kredi te llogarise 4341"Mardhenie me shtetin kreditor".
- **Rakordohet(Saktesohet) grupi i llogarive 23** "Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrushme) per aktivet qe jane blere e krijuar, te perfunduara e te marra ne dorzim per te cilat kryhet veprimi kredi llogarite perkatese te grupit 23 me kunderparti debitin e llogarive te grupit 20 e 21 te AQ. Per Investimet e ndertuara per te trete te perfunduara dhe te dorzuara te behet veprimi ne debi te llogarive te grupit 14"Grante per pjesmarrje per investime per te trete" me kunder parti kreditin e llogarive te grupit 23"AQ ne proces".

▪ **Procedura per veprimet e mbylljes se llogarive ;**

- **Stornohen fondet buxhetore** (korente apo kapitale) te pa perdorura ne fund te periudhes, me perjashtim te rasteve kur me dispozita ligjore ato trashegohen ne vitin pasardhes, me artikullin kontabel Debi (me storno) llogaria 520"Disponibilitete ne thesar" ne kredi(me storno) te llogarise 476"te ardhura te caktuara per t'u perdorur".
- **Mbi bazen e percaktimit te destinacionit te fondeve** ne fund te vitit ushtrimor realizohet procedura si me poshte ; Grantet e perdorura per shpenzimet e paguara te vitit ushtrimor (informacion qe merret nga levizja kreditore e llogarise 520 dhe vetem per pagesat qe kane pasur destinacion fondet buxhetore apo grante te huja, keto te fundit nqs jane kanalizuar nepermjet llogarise 476) nga institucionet veprimi te behet me kete artikull kontabel;
 - Debi llogaria 476"te ardhura te caktuara per t'u perdorur", per mbyllje (totali).
 - Kredi llogaria 720"Grante korente te brendeshme", per fondet e perdorura per funksionimin.
 - Kredi llogaria 105"Grante te brendeshme kapitale", per fondet buxhetore te perdorura per investime" apo 106"Grante te huaja kapitale" te perdorura per investime (ne se keto te fundit jane regjistruar ne llogarine 476).
- **Per rastet kur grantet e dhena destinohen** per pjesmarrje ne investimet per te trete atehere veprimi i mesiperme behet debi llogaria 476"Te ardhura te caktuara per t'u perdorur ne kredi te llogarive respektive 145"Grante te brendeshme kapitale per pjesmarrje ne investime per te trete" dhe 146"Grante te huaja kapitale per pjesmarrje ne investime per te trete".
- **Ne rastet kur grantet e perfituara per investime jepen** ne likujditet dhe trashegohen(bazuar ne kuadrin ligjor ne fuqi), keto regjistrohen direkt ne momentin e arketimit(kalimit) me veprin debi llogaria

520"Disponibilitete ne thesar" ne kredi te llogarive perkatese te granteve (105,106,145,146).

- **Per grantet e brendeshme e te huaja kapitale** qe institucioni perfiton ne natyre veprimi kontabel te behet direkt. Fillimisht debi llogarite e grupit 23 te AQ ne kredi te llogarive respektive 1059"Grante te brendshme kapitale ne natyre" dhe 1069"Grante te huaja kapitale ne natyre".dhe paralel debi llogarite perkatese te grupit 21 te AQ ne kredi te llogarive perkatese te grupit 23 "shpenzime per krijimin e AQ".
- **Per grantet e perdorura per blerje apo krijim aktivesh te perfunduara** (te cilat jane bere hyrje ne institucion ne llogarite e grupeve 20 e 21 te AQ) behet mbyllja duke debituar llogarite perkatese te granteve kapitale (105 e 106) ne kredi te llogarise 1011"Shtesa te fondit baze".
- **Per grantet e perdorura per pjesmarrje ne investime ne te trete** kur keto investime jane perfunduar e dorzuar tek te tretet, institucioni investues ben veprimin duke debituar llogarite perkatese te granteve ne proces(145 e 146) ne kredi te llogarive perkatese te grupit 23"Investime ne proces".
- **Mbyllet llogaria 520** "Disponibilitete ne Thesar" si me poshte ;
 - Kredi llogaria 520"disponibilitete ne thesar", per totalin
 - Debi llogaria 4341 per te ardhurat e arketuara qe i perkasin buxhetit te shtetit .dhe llogaria 116"te ardhura nga shitja e AQ (ne rastet kur institucionet nuk kane te drejte perdorimi ose trashegimie ne vitin pasardhes). Ky transaksion, nqs nuk jane bere me pare veprimet e konstatimit te transferimeve (dmth debi 8420,8421 e 8422 ne kredi te 4341), behet me veprimin ;
 - Kredi llogaria 520"disponibilitete ne thesar", per totalin
 - Debi llogarite 8420,8421 e 8422 per transferimet e te ardhurave ne buxhet.

Institucionet qe trashegojne te ardhura, sipas kuadrit ligjor ne fuqi, nga nje vit ushtrimor ne tjetrin nuk do te kryejne mbylljen e llogarise se disponibiliteteve ne Thesar. Llogaria 520, te pasqyrohet per teprice debitore ne Aktiv te Bilancit. Llogaria 520 nuk mbyllet edhe per gjendjen e mjeteve ne ruajtje (te evidentuara si te tilla ne llogarite e grupit 466), per sponsorizimet e te tjera te trashegushme. Teprica ne kete llogari, te vertetohet me aktrakordimin me Thesarin, nje kopje e se cilit duhet ti bashkangjitet llogarise vjetore. Ne aktrakordim teprica te paraqitet e strukturuar sipas natyres se te ardhurave te trasheguara (te ardhurat e paperdorura si te çelura ashtu edhe ato te pa çelura, mjetet ne ruajtje, sponsorizimet dhe pjesen e grantit qe trashegohet).

- **Mbyllet llogaria 116**"Te ardhura nga shitja e AQ" sipas rastit per tepricen debitore te saj duke kredituar kete llogari ne debi te llogarise 1012"Paksime te fondeve baze" dhe per tepricen kreditore te saj duke debituar kete llogari ne kredi te llogarise 1011"Shtesa te fondeve baze".
- **Mbyllet llogaria 115**"Te ardhura te funksionit te caktuara per investime" ne kredi te llogarise 1011"shtesa te fondeve baze" ne rast se investimet qe kane pasur per burim keto fonde jane te perfunduara e te marra ne dorzim nga institucioni.

- **Behet transferimi** per te perjashtuar ndikimin ne rezultat te efektit te ndryshimit te gjendjes se inventarit(informacion qe merret nga llogarite 63 e 73 te ndryshimit te gjendjeve) me veprimet;
 - Debi llogaria 8423 "Transferimi i ndryshimit te gjendjeve ne kredi te llogarise 1011"Shtesa te fondit baze" per rastet kur efekti eshte pozitiv qe ka cuar ne rritjen e gjendjes se inventarit gjate ushtrimit.
 - Kredi llogaria 841 "Transferimi i ndryshimit te gjendjeve ne debi te llogarise 1012"Paksime te fondit baze" per rastet kur efekti eshte negativ qe ka cuar ne uljen e gjendjes se inventarit gjate ushtrimit.
- **Mbyllet llogaria 1011**"shtese e fondeve baze" duke u debituar ne kredi te llogarise 1010 "fonde baze".
- **Mbyllet duke u kredituar llogarite respektive** 1012"Paksime te fondeve baze", 1013"konsumi i aktiveve te qendrushme", 1014"pasim fonde nga shitja e aktiveve te qendrushme, 1015"paksim fondi nga nxjerrja jasht perdorimit e AQ" dhe llogaria 1016"paksim fondi nga transfertat brenda e jasht sistemit " ne debi te llogarise 1010"Fonde baze".
- **Mbyllet te gjitha llogarite e klases 7 "Te ardhura"** me veprimin kontabel ;
 - Kredi llogaria 85"Rezultati i ushtrimit"
 - Debi llogarite perkatese te klases 7"llogari te te ardhurave" (perfshire edhe llogarine 73"ndryshimi i gjendjeve te produkteve" me efektin debitor ose kreditor te saj).
- **Mbyllet te gjitha llogarite e klases 6 "Shpenzime"** me veprimin kontabel ;
 - Debi llogaria 85"Rezultati i ushtrimit"
 - Kredi llogarite perkatese te klases 6"llogari te shpenzimeve" (perfshire edhe llogarine 63"ndryshimi i gjendjeve te inventarit" me efektin debitor ose kreditor te saj)
- **Mbyllet llogarite respektive te klases 8** per operacionet e korigjimit te rezultatit me veprimet kontabel;

Per operacionet e llogarive debitore

- Debi llogaria 85"Rezultati i ushtrimit"
- Kredi llogarite respektive operacionale si 828"Te ardhura te anuluar nga vitet e meparshme", 831"caktim i te ardhurave te funksionit per investime" 8420"transferim per derdhje te ardhura ne buxhet", 8421"Transferim per derdhje ne buxhet te te ardhurave te pa perdorura ne fund te vitit", 8422"Transferim te ardhurash brenda sistemit", 8423"Transferim i ndryshimit te gjendjeve" dhe 8424"Transferim per debitore te konstatuar e te ngjashem".

Per operacione e llogarive kreditore

- Debi llogarit respektive operacionale si 829"Shpenzime te anuluar nga vitet e meparshme dhe 841"Transferim i ndryshimit te gjendjeve"
- Kredi llogaria 85"Rezultati i ushtrimit"

Mbas te gjitha veprimeve te mbylljes se llogarive sipas procedures se mesiperme, Llogaria 85"Rezultatet nga funksionimi" perfaqeson si teprice kreditore rezultatit nga funksionimi qe rrjedh nga te ardhurat qe institucionit i mbeten (sipas dispozitave ligjore) per t'u trasheguar ne ushtrimet e mepasme.

Ne rastet eventuale te anulimit ne vitin ushtrimor te te drejtave e detyrimeve nga vitet e meparshme sipas skemes se mesiperme ne rezultat pasqyrohet edhe ky efekt qe institucioni duhet ta argumentoje ne te dhenat shpjeguese. Ne vitin e mepasem vetem ky efekt do te transferohet ne shtese apo paksim (sipas rastit) te fondeve baze te institucionit.

III. SHPJEGIME LIDHUR ME PERMBAJTJEN DHE PLOTESIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TE VITIT 2006

1. Per Aktivin e Bilancit kontabel(Formati nr. 1)

Informacioni kontabel per te gjitha rubrikat dhe postet aktivitet te bilancit kontabel plotesohen ne dy kollona, ushtrimi i mbyllur(tepricat me 31/12/2006) dhe ushtrimi paraardhes (tepricat me 01.01.2006).

- ◆ **Rubrike me vehete perben posti 12"Rezultate te mbartura",humbje nga vitet e meparshme(rrjeshti 1).**Ne kete post evidentohet humbja e mbartur nga rezultatet e ushtrimeve te meparshme.Sipas natyres se funksionimit te cdo institucioni humbja e mbartur te justifikohet me shkaqe ligjerisht te argumentuara ku institucioni detyrohet te jape te dhena shpjeguese. shoqeruese.
- ◆ **Ne rreshtin 2 perfaqesohet Grupi A "Aktive te qendrueshme"** qe ne kete pasqyre finaciare perfaqesohet nga shuma e tre rubrikave si me poshte ;
 - **Rubrika I** – AAGj jomateriale(rreshti 3 si shume algjebrike e rreshtave 4 deri 8) sipas llogarive ku amortizimi(llogaria 209) evidentohet me shenje(-)
 - **Rubrika II** – AAGJ materiale (rreshti 9 si shume algjebrike e rreshtave 10 deri 23) sipas llogarive ku amortizimi(llogaria 219) evidentohet me shenje(-)
 - **Rubrika III** – AAGj financiare (rreshti 24 si shume e rreshtave 25 e 26.
- ◆ **Ne rreshtin 27 evidentohet Grupi B "Aktive qarkulluese"** qe ne kete pasqyre financiare perfaqesohet nga shuma e tre rubrikave si me poshte;
 - **Rubrika I** – Gjendja e inventarit(klasa3) ne rreshtin 28 (si shume algjebrike e analizave te llogarive te materialeve, inventarit te imet, produkteve e mallrave ne rreshtat 29 deri 37) ku shumate e parashikuara per zhvlersim(ne rastet eventuale) paraqitet me shenje (-).
 - **Rubrika II** - Kerkesa arketimi mbi debitoret(rrjeshti 38 si shume algjebrike e analizave te te drejtave ne llogarite e evidentuara ne rreshtat 39 deri ne 53) ku shumate e parashikuara per zhvleresim ne llogarine 49 paraqitet me shenje (-). Brenda kesaj rubrike ne llogarine 409"Furnitore(debitore), parapagime e pagesa pjesore" (rrjeshti 39) evidentohen llogarite e furnitoreve per parapagime dhe pagesa pjesore (qe rezultojne si kerkesa debitore). Nuk lejohet qe mbetjet kreditore te llogarive (qe evidentojne kerkesa debitore mbi te tretet) te bashkohen me shumate perkatese te llogarive te

kerkesave kreditore. Po ne kete rubrike ne rrjeshtin 50, llogarite 45 "Marrdhenie mardhenie me institucionet Brenda e jashte sistemit" si rregull duhet te paraqiten me teprice zero. Perjashtimisht perfshihen tepricat debitore lidhur me levizjet e mjeteve materiale nga qendra ne njesi dhe anasjelltas, per te cilat nuk eshte realizuar perfundimisht mbyllja ne baze te konfirmimeve. Shifrat ne kete post kerkojne shpjegime ne pyetesor e te dhenat sqaruse.

- **Rubrika III** – perfaqeson ne rreshtin 54 llogarite e mjeteve monetare te klases 5 si shume algjebrike e llogarive qe analizohen ne rreshtat 55 deri 63 ku shumet e parashikuara per zhvleresim ne rastet eventuale te ndodhura (llogaria 59 ne rreshtin 53) paraqitet me shenje(-).

- ◆ **Ne grupi C "Llogari te tjera aktive "(rrjeshti 64)** perfaqsohen shuma per disa llogari te vecanta(477,481,486) ne rreshtat 65 deri 67.
 - Ne rrjeshtin 65, llogaria 477 "Diferenca konvertimi aktive" pasqyrohen diferencat aktive qe lidhen me konvertimet nga vlersimi(per kerkesat debitore dhe detyrimet te shprehura ne monedhe te huaj) me kurset e kembimit ne mbyllje te ushtrimit.Me celjen e llogatrive vitin e ardheshem kjo llogari kunderkalohet.
 - Ne rrjeshtin 66, evidentohet llogaria 481"Shpenzime per tu regjistruar ne disa ushtrime", karakteristike kryesisht per institucionet lokale.Eshte llogari rregulluese ku perfshihen shpenzimet e kryera per riparimet e medha, shpenzimet per punime parapregatitore te nje lloji veprimtarie, shpenzime te kryera gjate vitit ushtrimor(qe nuk perfshihen ne aktivet e qendrushme dhe nuk mund te rendohen teresisht ne rezultatin e ushtrimit). Keto shpenzime shperndahen (amortizohen) vitet e ardheshme.
 - Rrjeshti 67 perfaqson llogarine 486 "Shpenzime te periudhave te ardheshme".Kjo llogari perfshihet ne grupin e llogarive rregulluese. Perfaqesojne shpenzime per blerje ose sherbime, realizimi faktik i te cilave ndodh ne nje ushtrim te ardheshem (shpenzime te parapaguara), si p.sh. qera te paguara avance, prime te sigurimeve per rreziqe te paguara avance e tjera.
- ◆ **Rezultati i Ushtrimit, saldo debitore(rrjeshti 68)** perfaqeson tepricen debitore te llogarise 85"Rezultat i ushtrimit"(humbje nga viti ushtrimor). Shkaqet e kesaj humbjeje te shpjegohen ne relacionet qe shoqerojne llogarine e vitit 2006 pasi per institucionet qe nuk kryjne aktivitet ekonomik nuk ka kuptim humbja.
- ◆ **Ne rreshtin 69 pasqyrohet shuma totale e aktivitet te bilancit kontabel.** Qe perbehet na shuma e posteve apo rubrikave ne rreshtat(1+2+27+64+68).
- ◆ Ne rrjeshtat respektive (37,53,63) te rubrikave perkatese te aktivitet te bilancit paraqiten tepricat me shenje (-) te llogarive 39, 49, 59 , qe i korrespondojne **shumave te parashikuara per zhvleresim** Per keto poste te tregohet kujdes pasi ato plotesohen nga njesite me karakter ekonomik, te cilat me te ardhurat mbulojne shpenzimet e tyre, dhe kerkojne shpjegime, lidhur me kuadrin ligjor mbeshtetes. Ne rast se jane evidentuar vlera te tilla kerkohet argumentimi ne shenimet shpjeguese.

2. Per pasivin e bilancit kontabel(Formati nr.2)

Informacioni kontabel per te gjitha rubrikat dhe postet pasivit te bilancit kontabel plotesohen ne dy kollona, ushtrimi i mbyllur(tepricat me 31/12/2006) dhe ushtrimi paraardhes (tepricat me 01.01.2006).

- **Ne grupin A “Fonde te veta “(rrjeshti 1)** perfshihet shuma algjebrike e gjashte rubrikave si me poshte;
 - **Rubrika I** – “Fonde te veta”(rrjeshti 2) perfaqeson shumen e llogarive te fondeve sipas rrjestave 3 deri ne 7. Ne kete rubrike llogarite 105 e 106(rrjeshtat 4 e 5) mbeten me teprice vetem ne rastet kur keto grante si burim kane investimet ne proces per institucionin(te pa perfunduara ose te pa marra ne dorzim). Ne aktiv te bilancit keto jane investime ne proces ne grupin e llogarive 23. Keto mbyllen(kapitalizohen) me fondet baze ne kohen kur investimi eshte perfunduar dhe marre ne dorzim. Llogaria 107"mjete te caktuara ne perdorim"(rrjeshti 6) evidenton vleren neto te aktiveve qe kane marre ne perdorim.Teprica e saj tregon se keto aktive nuk jane te vetat. Llogaria 109"Rezerva nga rivlersimi" (rrjeshti 7) perfaqeson diferencat nga rivlersimi qe u behet aktiveve te qendrushme, te cilat kryhen me Vendim te Keshillit te Ministrave.
 - **Rubrika II „Fonde te tjera te veta“ (rrjeshti 8)** perbehet nga shuma e rrjestave 9, 10, 11. Ne te pasqyrohen fondet rezerve per shpenzime korrente si;
 - Llogaria 111 (rrjeshti 9) per tepricen midis fondeve te krijuara nga rezultatet e mbartura dhe atyre te perdorura gjate vitit per shpenzime korrente(ne perputhje me aktet ligjore e nenligjore),
 - Llogaria 115" Caktim nga rezultati i vitit per investime"(rrjeshti 10) perfaqeson pjesen qe caktohet nga rezultati per mbulimin e shpenzimeve te kryera gjate vitit ushtrimor per investime dhe te mbulara nga te ardhurat e krijuara gjate vitit ne seksionin e funksionimit,
 - logarina 116"Te ardhura nga shitja e aktiveve te qendrushme" (rrjeshti 11) evidenton tepricen e plus-minus vlerave qe lidhen me shitjet eventuale te elementeve te pasurise. Ne kushtet e mosekzistences se te drejtes se trashegimit te plusvlerave te realizuara, ky post paraqitet me vler zero. (Integrohet ne llogarine 1011/ 1012)
 - **Rubrika III** , rezultate te mbartura,(rrjeshti 12) evidenton llogarine 12 me te njejtin emertim qe perfaqeson rezultatin e trasheguar nga viti ose vite te meparshme. **Ne te dhenat shpjeguese** te llogarise vjetore 2006 te shpjegohet bazueshmeria ligjore e rezultatit te trasheguar dhe te sqarohet perberja e tij (ne ndarjen te konstatuara dhe te arketuara).
 - **Rubrika IV**, Subvecione te jashtezakonshme, (llogaria 13, rrjeshti 13) perfaqeson kete llogari me shenje (-). Jane subvecione per investime te atribuara nga organe te pushtetit vendor per nje organ tjeter vendor. Evidentohen te dhena ne perputhje me hapesirat

aktuale ligjore qe lindin te tilla mardhenie te cilat duhet te shpjegohen ne relacionet shoqeruese. Per vitin 2006 nuk funksionon.

- **Rubrika V**, Grante per pjesmarrje ne investime per llogari te te treteve (llogaria 14, rrjeshti 14), perfaqesohet nga kjo llogari dhe pasqyron shumet e perdorura per financimin e investimeve ne proces per llogari te te treteve.
 - **Rubrika VI**, provizione te parashikuara per rreziqe e shpenzime (rrjeshti 15). Perfaqesohet nga llogaria 15 me te njejtin emertim. Provizione te tilla krijohen kryesisht per njesite me karakter ekonomik.
- **Grupi B " Detyrime"**(rrjeshti 16) perfaqesohet nga shuma e borxheve afatgjate (rrjesht 17) dhe detyrimeve afatshkurter"(rrjeshti 20) dhe konkretisht:
 - **Borxhet afatgjata** perbejne shumen e rrjeshtave 18 e 19 (respektivisht per llogarite 16 e 17 te huamarrjeve), mbeshtetur ne dispozitat ligjore ne fuqi, ne rastet kur institucionet kane mardhenie me banka apo institucione krediti te vendit apo te huaja. Plotesimi i ketyre posteve kerkon shpjegime ne relacionin shoqerues te bilancit lidhur me kuadrin ligjor mbeshtetes dhe natyren e huave.
 - **Detyrime afatshkurter** (rrjeshti 20). Perfaqesohet nga llogarite me teprice kreditore te klases 4 si shume e llogarive perkatese ne rrjeshtat (21 deri 36). Ne rrjeshtin 21(llogaria 419"Kliente, kreditore") evidentohen llogarite e klienteve per parapagime dhe pagesa pjesore te kryera(qe kane rezultuar si kerkesa kreditore). Nuk lejohet qe mbetet debitore te llogarive (qe evidentojne detyrime kreditore nga te trete) te bashkohen me llogarite perkatese detyrimeve kreditore (parimi i moskompensimit). Ne rrjeshtin 27, llogaria 4341 "Te tjera operacione me shtetin - Kreditor", pasqyron detyrimet e konstatuara te institucionit ndaj Shtetit per operacione te ndryshme buxhetore qe lidhen me te. Ne kete llogari evidentohet edhe pjesa e buxhetit per te ardhurat e konstatuara qe ne mbyllje te ushtrimit rezultojne te pa arketuara. Po ne kete rubrike ne rrjeshtin 32, llogarite 45 "Marrdhenie mardhenie me institucionet Brenda e jashte sistemit" si rregull duhet te paraqiten me teprice zero. Perjashtimisht perfshihen tepricat kreditore lidhur me levizjet e mjeteve materiale nga qendra ne njesi dhe anasjelltas, per te cilat nuk eshte realizuar perfundimisht mbyllja ne baze te konfirmimeve. Shifrat ne kete post kerkojne shpjegime ne pyetesor e te dhenat sqaruse.
 - **Grupi C "Llogari te tjera"**(rrjeshti 37) perfaqesohet nga shuma e posteve qe perfshihet ne rrjeshtat (38 deri 41). Ne rrjeshtin 38 perfaqesohet llogaria 475"Te ardhura per tu regjistruar vitet pasardhese" e cila hyn ne grupin e llogarive rregulluese. Sipas rastit te cdo institucioni evidentohen te ardhurat qe jane arketuar perpara ngjarjes ose veprimit qe krijon te ardhura. Ne rrjeshtin 39, llogaria 478 "Diferenca konvertimi pasive" pasqyron diferencat pasive qe lidhen me konvertimet qe rezultojne nga vleresimi me kurset e kembimit ne mbyllje te ushtrimit(te kerkesave

debitore dhe detyrimeve) te shprehura ne monedha te huaja. Ne rrjeshtin 40, llogaria 480 "Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar" pasqyron te ardhura te arketuara, por me dokumentacion te pa plotesuar ose te paqarte deri ne daten e mbylljes se bilancit kontabel te institucionit. Teprica kreditore e kesaj llogarie kerkon sqarime ne te dhenat shpjeguese. Ne rrjeshtin 41, llogaria 487 "te ardhura te arketuara para nxjerrjes se titullit" rregjistron te ardhurat e arketuara , te cilat ekzistojne ne institucion te derdhura por nuk eshte marre konfirmim nga Thesari deri ne 31.12.2006.

- **Llogaria 85"Rezultati i ushtrimit"**, (rrjeshti 42), perfaqesohet si rubrike me vehte dhe perben rezultatin nga viti ushtrimor si teprice kreditore e kesaj llogarie.
- **Totali i pasivit te bilancit kontabel**_(rrjeshti 43) perben shumen e bilancit sipas rubrikave ne rrjeshtat (1 + 16 + 37 + 42) te kesaj pasqyre financiare.

3. Pasqyra Financiare "Shpenzime te vitit ushtrimor" (Formati nr. 1/1)

Kjo perben nje nga pasqyrat financiare kryesore te seksionit te funksionimit te vitit 2006 ne perberje te llogarise vjetore dhe perfaqeson shpenzimet e konstatuara dhe operacionet e korigjimit te rezultatit te vitit ushtrimor .Hartohet e krahasuar ku ne kolonen 1 perfaqesohet informacioni sipas rrjeshtave per vitin ushtrimor(31/12/2006) dhe ne kolonen 2 i njeiti informacion por per vitin e meparshem(01.01.2006).

- ◆ **Grupi A. "Shpenzime te shfrytezimit"(rrjeshti 1)** perfaqesohet nga shuma e rubrikave te meposhtme te cilat evidentojne ;
 - **Ne Rubrika I** (rrjeshti 2) "Shpenzime korrente" qe ne vetvete perbehet nga shuma e nenrubrikave ; "Paga e shperbilime te tjera personeli"(llogaria 600 ne rrjeshtin 3), "Kontribute te sigurimeve shoqerore e shendetesore"(llogaria 601 ne rrjeshtin 8), "Mallra dhe sherbime te tjera"(llogaria 602 ne rrjeshtin 11), "Subvecionet"(llogaria 603 ne rrjeshtin 22), "Transferimet korrente te brendshme"(llogaria 604 ne rrjeshtin 28), "Transferimet korrente me jashte"(llogaria 605 ne rrjeshtin 33) dhe "Transfertat per buxhete familjare e individe"(llogaria 606 ne rrjeshtin 38). Ne nenrubrikat respektive te permendurraa ne kete paragraf analizohen emertimet dhe strukturat ne nivelet e llogarive kater shifrore. Ne analizat e llogarive te grupit 600"Paga e shpenzime te tjera personeli, evidentohen pagat bruto te konstatuara te personelit te perhershem apo te perkohshem si dhe shperblimet apo shpenzimet e tjera te personelit ne nivelin bruta (pa ndalesat). Ne grupin e llogarise 601 me analiza perfaqesohen sigurimet shoqerore e shendetesore qe paguhen nga punedhenesi (por jo ndalesat qe paguhen nga punemarresi).
 - **Ne Rubriken II** (rrjeshti 41) paraqiten ndryshimet e gjendjeve per materialet e mallrat e stokuara ne magazine sipas te dhenave debitore (+) apo kreditore (-) te grupit te llogarive 63"Ndryshimi i gjendjeve te inventarit".

- **Ne rubriken III** (rrjeshti 42) " Kuota amortizimi e shuma te parashikuara" evidenton llogarite e grupit 68 te Planit Kontabel Publik. Ne kete rubrike te plotesohen te dhenat per ato institucione (lokale ose nacionale) qe ushtrojne edhe aktivitet ekonomik (prodhues apo tregetar), te cilat llogarisin e rendojne ne shpenzime amortizimin apo kuotat e parashikuara ne aktivet e qendrushme.
- ◆ **Grupi B. "Shpenzime financiare"(rrjeshti 47)**, perfshin shumen e dy rubrikave si me poshte;
 - **Rubrika I** (rrjeshti 48) "Shpenzime financiare te brendshme"perfaqeson shumen (te analizuara ne tre shifra te llogarive te grupit 65 per interesa per bono thesari, interesa per huamarrje te tjera te brendshme, interesa per letra te tjera me vlere te Qeverise dhe shpenzime nga kembimet valutore, rrjeshtat 49 deri 52).
 - **Rubrika II** (rrjeshti 53)"Shpenzime financiare te jashtme" perfaqeson shumen (sipas analizes se llogarive treshifrore te grupit 66 ku perfshihen interesat per huamarrje nga Qeveri te huaja, interesat per financime nga institucionet nderkombtare dhe interesat per huamarrje te tjera te jashtme, rrjeshtat 54 deri 56). Keto plotesohen nga institucionet lokale dhe institucionet nacionale qe kane shpenzime te tilla me karakter financiar.
- ◆ **Grupi C. "Shpenzime te jashtzakonshme"(rrjeshti 57)**. Ne kete rubrike te gjitha institucionet pasqyrojne te dhenat sipas grupit te llogarive 67"Shpenzime te jashtzakonshme" qe perbehet nga shuma e rrjeshtave 58 dhe 59. Natyra e tyre duhet te sqarohet ne te dhenat shpjeguse.
- ◆ **Totali i operacioneve te shpenzimeve korrente(rrjeshti 60)**.Perfaqeson shumen e shpenzimeve (Klasa 6), totali i rubrikave ne rrjeshtat (1+47 +57).
- ◆ **Grupi D. Operacione te korrigjimit te rezultatit (rrjeshti 61)** Perbehet nga shuma e rrjeshtave 62 deri 68 ku perfshihen llogarite e klases 8 ne sencin debitor te grupeve 82, 83 dhe 84 te cilat jane shpjeguar ne kete udhezim.
- ◆ **Totali i operacioneve(rrjeshti 69)**. Perbehet nga shuma e rrjeshtave (60+61). Perfaqeson shumen totale te llogarive te klases 6 e klases 8, pa perfshirjen e llogarise 85"Rezultati i veprimtarise".
- ◆ **Rezultati i veprimtarise (rrjeshti 70)**. Perfaqeson tepriken kreditore te llogarise 85"Rezultati i ushtrimit" .Sipas kollonave perkatese pefaqeson diferencen pozitive midis totalit te operacioneve te te ardhurave (rrjeshti 86 i pasqyres 1/2"Te ardhura te seksionit te funksionimit") me totalin e operacioneve te shpenzimeve (rrjeshti 69 i pasqyres 1/1"Shpenzime te seksionit te funksionimit"). Detyrimisht shifra e perfaqesuar ne kete pasqyre (Pasqyra 1/1) duhet te jete e barabarte me llogarine 85"Rezultati nga ushtrimi" qe pasqyrahret ne pasiv te bilancit kontabel.
- ◆ **Totali i pasqyres 1/1(rrjeshti 71)**. Perben shumen e gjithe operacioneve (rrjeshtat 69+70). Shuma totale e kesaj pasqyre eshte e barabarte me totalin e pasqyres 1/2.

4. Pasqyra Financiare”Te ardhura te vitit ushtrimor”(Formati nr.1/2)

Kjo perben nje nga pasqyrat financiare kryesore te seksionit te funksionimit te vitit 2006 ne perberje te llogarise vjetore dhe perfaqeson te ardhurat e konstatuara dhe operacionet e korigjimit te rezultatit te vitit ushtrimor .Hartohet e krahasuar ku ne kolonen 1 perfaqesohet informacioni sipas rrjeshtave per vitin ushtrimor(31/12/2006) dhe ne kolonen 2 i njeiti informacion por per vitin e meparshem(01.01.2006).

➤ **Grypi A "Te Ardhura te shfrytezimit" (rrjeshti 1).** Ne kete grup te kesaj pasqyre financiare evidentohen shuma e 6 rubrika kryesore si ;

- **Rubrika I** – Te ardhura Tatimore
- **Rubrika II** – Kontribute shoqerore e shendetesore
- **Rubrika III** – Te ardhura jo tatimore
- **Rubrika IV** – Grante korrente
- **Rubrika V** – Ndryshimi i gjendjeve
- **Rubrika VI** – Punime per investime e rimarrje

- **Ne rubriken I - (rrjeshti 2),** perfaqesohen llogarite e grupit 70 "Tatime"si shume e nenrubrikave ne rrjeshtat (3+8+12+18+23+24+25) qe plotesohen nga organet e sistemit tatimor e doganor dhe lidhen me ;

- **Ne rrjeshtin 3** - llogaria 700,post (a) evidentohen te dhenat per te ardhurat bruto nga tatimet mbi te ardhurat personale , fitimin dhe te ardhurat kapitale, te paraqitura ne nivel katershifror (shuma e rrjeshtave 4 deri ne 7). Keto poste plotesohen nga organet e sistemit tatimor.
- **Ne rrjeshtin 8** –llogaria 702, post (b) “Tatime mbi pasurine” evidentohen te ardhurat e kesaj natyre ne nivele katershifrore sipas pershkrimeve ne kete pasqyre(shuma e rjeshtave 9 deri 11).
- **Ne rrjeshtin 12,** llogaria 703, post (c) “Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit” evidentohen te ardhurat e kesaj natyre sipas pershkrimeve ne kete pasqyre ne nivele katershifrore(shuma e rrjeshtave 13 deri 17).
- **Ne rrjeshtin 18,** llogaria 704, post (d) “Takse mbi tregtine e transakcionet nderkombtare” evidentohen te ardhurat e kesaj natyre sipas pershkrimeve ne kete pasqyre ne nivel katershifror(shuma e rrjeshtave 19 deri 22).
- **Ne rrjeshtat 23, 24, 25** evidentohen perkatesisht, post (e) ne llogarine 705”Taksa e rruges”, post (f) ne llogarine 708”Te tjera tatime e taksa kombtare” dhe post (g) ne llogarine 709”Kamat vonesa”.

- **Ne Rubriken II – (rrjeshtin 26)** evidentohet informacioni kontabel qe lidhet me kontributet e detyrueshme te sigurimeve shoqerore e shendetesore, ne llogarite e grupit 75, si shume me analiza treshifrore te llogarive te kontributeve(te punesuarit, punedhenesit, te vetepunesuarit, fermeret, sigurimet vullnetare, kontribute te buxhetit per sigurime shoqerore dhe

kontribute te buxhetit per sigurime shendetesore) si shume e rrjeshtave 27 deri 33.

- **Ne Rubriken III – (rrjeshti 34) perfaqesohet** grupi i llogarive 71 “Te ardhura jo tatimore” si shume e nenrubrikave(rrjeshtat 35+39+47) ku;
 - **Rrjeshti 35** –llogaria 710, posti (a) “Te ardhura nga ndermarrjet e pronesia” perfshin te ardhurat ne forme dividenti nga ndermarrjet publike e shoqerite e perbashketa, financiare e jo financiare (ne analiza katershifrore shuma e rrjeshtave 36+37+38). Plotesohet nga institucionet qe kane forma te tilla pronesie sipas kuadrit ligjor qe rregullon keto marrdhenie.
 - **Rrjeshti 39** – llogaria 711, posti (b) “Sherbime administrative e te ardhura sekondare” pasqyron te ardhurat per bruto sipas natyres te realizuara nga institucionet nga aktiviteti i tyre sekondar, Keto mbahen te analizuara ne kontabilitet sipas perqindjeve te pjesemarrjes se institucionit dhe te buxhetit ne keto te ardhura. Perbehet nga shuma e rrjeshtave 40 deri 46, qe perfaqsojne analiza katershifrore.
 - **Rrjeshti 47** – llogaria 719, posti (c) “Te tjera te ardhura jotatimore” pasqyron te gjitha te ardhurat jotatimore , te cilat nuk jane pasqyruar ne postet e mesiperme.

- **Ne Rubriken IV – (rrjeshtin 48)**- grupi 72 “Grante korente” pasqyron shumen e granteve ne llogarite 720 “Grante korrente te brendshem”, rrjeshti 49, posti (a) dhe 721 “Grant korent i jashtem”, rrjeshti 59 posti (b). Konkretisht;
 - **Llogaria 720**, posti (a) “Grant korent i brendshem” perbehet nga shuma e rreshtave 50 deri 58, sipas natyres se granteve. Ketu perfshihen nenllogarite me kater shifra si 7200 “Grant nga i njeiti nivel qeverisjeje” e parashikuar per pasqyrimin e granteve nga buxheti ose jo, te perdorura per shpenzime korente nga institucionet e te njejit nivel qeverisjeje; 7201“Grant nga nivele te tjera qeverisjeje” e parashikuar per pasqyrimin e granteve per shpenzime korrente, te marra ne qeverine qendrore nga ajo vendore dhe anasjelltas; 7202 dhe 7203 grante te marra ne institucionet e sigurimeve shendetesore e shoqerore nga buxheti qendror; 7204 “Pjesemarrje e institucionit ne tatimet e taksat nacionale” e parashikuar per tarifen qe perfitojne agjentet tatimore nga te ardhurat e arketuara, sipas akteve ligjore e nenligjore ne fuqi; 7205 “Financim shtese nga te ardhurat e krijuara brenda sistemit” (funksionimi sipas pershkrimimit te bere me kete udhezim); 7206 “Financim i pritshem nga Buxheti”, 7207 “Sponsorizimet” dhe 7208 “Te tjera grante”.
 - **Llogaria 721**, posti (b) “Grant korent i jashtem” paraqet shumen e rrjeshtave 60 e 61 lidhur me grantet e marra nga qeveri te huaja apo institucione nderkombetare.

- **Ne Rubriken V – (rrjeshtin 62)** - Grupi 73 perfaqeson tepricen (+ ose -) te llogarive 73 nga ndryshimi i gjendjes se produkteve te gatshme e prodhimit ne proces.

- **Ne Rubriken VI – (rrjeshtin 63)** – grupi 78 “Punime per investime dhe rimarrje te shumave te parashikuara” perfaqeson shumen me te dhenat sipas

rrjeshtave 64 deri 69 sipas llogarive ne nivel tre shifror te paraqitura ne kete pasqyre financiare. Rrjeshti 64, llogaria 782 "Punime e investime ne ekonomi" perfaqson te ardhurat e evidentuara per kete llogari lidhen me rimarrjen si te ardhura te shpenzimeve te kryera ne klasen 6 (materiale, personeli, etj) ne institucion per realizimin ne ekonomi te aktiveve te qendrueshme. Ne rrjeshtat respective 65,66,67,68 (llogarite 782 deri 785) pasqyrohen ne nivel treshifror llogarite e te ardhuarve per rimarrjen e shumave te parashikuara, Si rregull keto perdoren ne institucionet me karakter ekonomik. Ne rrjeshtin 69 te evidentohen te dhenat per te ardhurat sipas llogarise 787 "Terheqje nga seksioni i investimeve", lidhur me fondin nga rezultati i mbartur, te perdorur per shpenzime korente.

- **Grupi B "Te ardhura financiare"(rrjeshti 70).** Si per institucionet nacionale ashtu dhe per vendoret perdoret grupi i llogarive 76 me te njejtin emer. Perbehet nga shuma e rrjeshtave 71 deri 74. Rrjeshti 71 - llogaria 760 "Te ardhura nga interesat e transaksioneve te huadhenies se brendshme" sipas rasteve eventuale perfaqeson te ardhura nga interesat per letrat me vlere te vendosjes, interesat lidhur me huadhenie te tjera te brendshme. Ne llogarine 761 (rrjeshti 72) perfaqesohen interesat nga huadhenia e huaj. Ne llogarine 765 (rrjeshti 73) perfaqesohen te ardhurat nga interesat e depozitave per institucionet qe kane llogari bankre. Te tre keta poste plotesohen nga institucione specifike qe kane te tilla te ardhura. Ne rrjeshtin 74 perfaqesohet llogaria 766 "Te ardhura nga kembimet valutore" ku perfshihen te ardhurat nga kembimet valutore e ndonje tjetër i ngjashem.
- **Grupi C "Te ardhurat e jashtzakonshme" (rrjeshti 75)** pasqyron te ardhurat e konsideruara si te tilla nese ka raste te argumentuara. Perben shumen e rrjeshtave (76 deri 79), sipas emertimit e analizave ne kete pasqyre financiare.
- **Totali i operacioneve te te ardhurave (rrjeshti 80).** Perfaqeson shumen e te ardhurave (Klasa 7). Perbehet nga totali i rubrikave ne rrjeshtat (1 + 70 + 75).
- **Operacione te korrigjimit te rezultatit (rrjeshti 81)** Perbehet nga shuma e rrjeshtave (82, 83) ku perfshihen llogarite e klases 8 qe lidhen me operacionet buxhetore te institucionit. Rrjeshti 82, perfaqeson llogarine 829 "Urdhra shpenzimesh te anuluar". Perfshihen te dhenat lidhur me anulimin e urdhrave te shpenzimeve te konstatuara ne vitet e kaluara te cilat gjykohen te papagueshme. Rrjeshti 83, perfaqeson operacionet lidhur me transferimin nga efektet qe rrjedhin nga tepricat debitore te llogarive 63 e 73 "Ndryshimi i gjendjeve" ne mbyllje te ushtrimit. Eshte theksuar qe keto efekte nuk do te pasqyrohen ne rezultatin e ushtrimit.
- **Totali i operacioneve (rrjeshti 84).** Perbehet nga shuma e rrjeshtave (80+81). Perfaqeson shumen e llogarive te klases 7 e klases 8, pa perfshirjen e llogarise 85 "Rezultati i veprimtarise".
- **Rezultati i veprimtarise (rrjeshti 85).** Perfaqeson llogarine 85 "Rezultati i ushtrimit", humbje nga veprimtaria. Sipas kollonave perkatese perfaqeson diferencen midis totalit te operacioneve te shpenzimeve i pasqyres 1/1 "Shpenzime te ushtrimit" me totalin e operacioneve te te ardhurave i

pasqyres 1/2"Te ardhura te ushtrimit"). Eshte e barabarte me tepricen debitore te llogarise 85 "Rezultat i ushtrimit" qe pasqyrohet ne aktiv te bilancit kontabel.

- **Totali i pasqyres 1/2 (rrjeshti 86).** Perben shumen e gjithë operacioneve (shuma e rrjeshtave 84+85).Totali i kesaj pasqyre eshte e barabarte me totalin e pasqyres 1/1.

5. Shpenzimet e lidhura me investimet(Formati nr. 2/1)

Kjo pasqyre paraqet levizjet dhe tepricat e llogarive te shpenzimeve te lidhura me investimet, principialet e huadhenieve, pagesat e principialeve te huamarrjeve, etj.

- **Sipas rrjeshtave** jepen llogarite e grupit 23 "Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme"(te analizuara per llogarite 230,231,232), llogaria 255 "Te dala per huadhenie dhe nenhuadhenie te brendshme", 256 "Te dala per huadhenie jashte vendit", 265 "Te dala per kapitale te veta ne ndermarjet publike jofitimprurese", 266 "Te dala per kapitale te veta ne institucione financiare", 267 "Te dala per kapitale te veta ne joint venture", 269 "Te dala per kapitale te veta te tjera", 165 "Bono thesari dhe kredi direkte –te dala", 166 "Huamarrje te tjera te brendshme – te dala", 167"huamarrje ne letra me vlere, 175 "Huamarrje nga qeveri te huaja- te dala", 176 "Institucione nderkombetare – te dala", 177 "huamarrje te tjera te jashtme- te dala". Paraqitja e informacionit ne kete pasqyre behet ne nivel nenllogarie katershifrore per llogarite treshifrore te permendura me lart. Rrjeshtat e llogarive jane te barabarta me shumen e rrjeshtave te analizave katershifrore te ketyre llogarive.
- **Sipas kolonave** (c,d,e,f) kjo pasqyre paraqet:
 - Tepricen e ketyre llogarive ne celje te vitit ushtrimor -kolona (c) duhet te jete respektivisht sa celja e ketyre llogarive ne bilanc.
 - Debitimet lidhur me transaksionet e vitit - kolona (d), pasqyron veprimet e vitit per shitesat.
 - Kreditimet lidhur me transaksionet e vitit - Kolona (e), pasqyron veprimet e vitit per paksimet.
 - Tepricen ne fund te vitit ushtrimor - kolona (f) perfaqeson perkatesisht per cdo llogari sipas rrjeshtave kolonat (c+d-e).
- **Totali i Pasqyres (rrjeshti 56 sipas kolonave)** eshte i barabarte me shumen e rrjeshtave 1, 7, 10, 14,17,20,23,27,37,47,51,52,53,54,55.

6. Te ardhurat e lidhura me investimet(Formati nr. 2/2)

Kjo pasqyre paraqet levizjet dhe tepricat e llogarive te granteve, huamarrjeve dhe te ardhurave te tjera te lidhura me investimet.

- **Sipas rrjeshtave** paraqiten llogarive 105 "Grante te brendshme kapitale", 106"Grante te huaja kapitale", 107"Vlera e mjeteve te caktuara ne perdorim", 109 "Rezerva nga rivlersimi", 115 "Caktime nga rezultati i vitit per investime",

116 “Te ardhura nga shitja e aktiveve te qendrueshme”, 145 “Grante te brendshme per pjesemarrje ne investime per llogari te te treteve”, 146 “Grante te jashtme per pjesemarrje ne investime per llogari te te treteve”, 160 “Bono thesari dhe te tjera letra me vlere – te hyra”, 161 “Te tjera huamarrje te brendshme – te hyra”, 162”huamarrje ne letra me vlere – te hyra”, 170 “Huamarrje nga qeveri te huaja– te hyra”, 171 “Huamarrje nga institucione nderkombetare – te hyra”, 172 “Huamarrje te tjera te huaja”, 250 “Te hyra nga principali i huadhenies se brendshme”, 251 “Te hyra nga principali i huadhenies se huaj”. Paraqitja e informacionit ne kete pasqyre behet ne nivel nenllogarie katershifrore per llogarite treshifrore te permendura me lart. Rrjeshtat e llogarive jane te barabarta me shumen e rrjeshtave te analizave katershifrore te ketyre llogarive.

- o **Sipas kolonave** kjo pasqyre paraqet ;
 - Tepricen e ketyre llogarive ne celje te vitit ushtrimor -kolona (c) duhet te jete respektivisht sa celja e ketyre llogarive ne bilanc.
 - Debitimet lidhur me transaksionet e vitit - kolona (d), pasqyron veprimet e vitit per paksimet.
 - Kreditimet lidhur me transaksionet e vitit - Kolona (e), pasqyron veprimet e vitit per shtesat.
 - Tepricen ne fund te vitit ushtrimor - kolona (f) perfaqeson perkatesisht per cdo llogari sipas rrjeshtave kolonat (c-d+e).
- o **Totali i Pasqyres** (rrjeshti 50 sipas kolonave) eshte i barabarte me shumen e rrjeshtave te llogarive (rrjeshtat 1, 6,10,11,12,13,20,21,22,28,31,35,38,41,44, 48)

7. Levizja e disponibiliteteve (Formati nr.3)

Ne kete pasqyre jepet nje tablo e gjendjeve dhe levizjeve te mjeteve monetare te institucionit gjate vitit ushtrimor ne **Thesar** dhe ne **Banke**, duke dalluar ndikimin e operacioneve te funksionimit, te operacioneve te investimeve dhe operacioneve te tjera ne levizjet e mjeteve monetare. Informacioni per plotesimin e kesaj pasqyre do te merret nga rregjistrimet ne llogarine e disponibiliteteve ne Banke ose ne Thesar dhe nga rakordimi vjetor midis institucionit dhe deges se Thesarit te rrethit. Shifrat e paraqitura ne rubrikat e Disponibiliteteve ne Thesar duhet te kontrollohen vecanerisht nga inspektorët e kontabilitetit per realizimin e perputhjes se tyre me shifrat e deges se Thesarit.

- ◆ **I “Teprica ne Celje”**(rrjeshti 1) pasqyron ne kolonen “Debi” tepricen ne celje te vitit ushtrimor te mjeteve monetare disponibel ne thesar dhe ne Banke . (Teprica ne celje ne kete pasqyre duhet te jete e barabarte me llogarite perkatese (520 e 512) tek rubrika e llogarive financiare ne aktiv te bilancit.
- ◆ **II “Arketimet ne Cash”**(rrjeshti 2. kolona “c” dhe “e”) jane shume e rrjeshtave 3 deri ne 6 sipas pershkrimeve. Kolonat “d” dhe “f” te kesaj rubrike per zerat me shenjen “x” nuk plotesohen.
- ◆ **III “Pagesat e vitit ne Cash ”** (rrjeshti 7, kolonat « d » dhe « f ») jane shume e rrjeshtave 8 deri 12 sipas pershkrimeve. Kolonat “c” “e” te kesaj rubrike zerat me shenjen “x” nuk plotesohen.

- ◆ **IV “Transferta”** (rrjeshti 13) perfaqeson shumen sipas kolonave te rrjeshtave 14 deri 17 sipas pershkrimeve. Ne kete rubrike, zerat me “x” per kolonen “c” dhe “e” nuk plotesohen.
- ◆ **V “Shuma e levizjeve”** (rrjeshti 18) pasyron sipas kolonave totalin e levizjeve debitore dhe kreditore te mjeteve monetare te pasqyruara ne rrjeshtat (1+7+13).
- ◆ **VI ‘Teprica ne mbyllje’** (rrjeshti 19) pasqyron tepricen e llogarise se disponibiliteteve ne Thesar e ne Banke ne fund te vitit ushtrimor. Kjo teprice pasqyrohet respektivisht ne rrjeshtin 19, kolonat “c” dhe “f”, dhe eshte e barabarte me diferencen, per shumat e rrjeshtit 18 (kolona “c” minus kolonen d”) si dhe per shumat e rrjeshtit 18(kolona “e” minus kolonen “f”). Keto teprica(rrjeshti19) rakordon me shumen qe figuron ne postet perkatese te llogarive financiare (520 e 512) per ushtrimin e mbyllur ne aktiv te bilancit.

8. Gjendjet dhe ndryshimet ne Aktivet e Qendrushme me vleren bruto (Formati nr.4)

Kjo pasqyre plotesohet per Aktivevet e Qendrushme me vleren bruto sipas kriterave te vleresimit te percaktuara . Ne pjesen horizontale percaktohet sipas kolonave gjendja ne celje te ushtrimet, shtesat e paksimet sipas zerave dhe celja ne mbyllje te ushtrimit. Vertikalisht jane emertuar sipas zerave llogarite e aktiveve te qendrushme te trupezuara e te pa trupezuara si dhe totalet e tyre.

Horizontalisht : “Gjendja ne mbyllje te ushtrimit” e çdo reshti eshte shume e kolonave : “Gjendja ne çelje te ushtrimit” plus “Shtesat gjithesej” minus “Pakesimet gjithesej” (Kolona 11 = Kolonat 1+6-10). Shtesat gjithesej sipas rrjeshtave kolona 6 = kolonat 2+3+4+5. Paksimet gjithesej sipas rrjeshtave kolona 10 = kolonat 7+8+9.

Vertikalisht : Sipas kolonave Rubrika I (rrjeshti 1) per aktivet e pa trupezuara perben sipas emertimeve shumen e rrjeshtave 2 deri ne 4. Po sipas kolonave. Rubrika II (rrjeshti 5) per aktivet e trupezuara perben sipas emertimeve shumen e rrjeshtave 6 deri ne 18. Totali i pergjithshem i aktiveve te qendrushme per çdo kolone(rrjeshti 19) eshte shume e dy rubrikave ne rreshtat 1+5.

Gjendjet ne celje dhe ne mbyllje te ushtrimit per cdo kategori te aktiveve te qendrushme duhet te jene detyrimisht te barabarte me te dhenat e evidentuara per to ne postet e aktiveve te Qendrushme ne aktiv te bilancit kontabel.

9. Pasqyra e amortizimeve(Formati nr.5)

Kjo pasqyre perfaqeson gjendjet dhe ndryshimet ne total per amortizimin e aktiveve te qendrushme te trupezuara e te pa trupezuara. Ne te perfaqesohet amortizimi i akumuluar ne celje, amortizimi vjetor i llogaritur dhe gjendja e akumuluar ne fund te periudhes. Amortizimi vjetor llogaritet per cdo aktiv, pavarsisht se ne kete pasqyre evidentohet ne total.

Horizontalisht : “Shuma e akumuluar ne mbyllje te ushtrimit” e çdo reshti eshte shume e kolonave sipas emertimeve 1+4-8(“Shume akumuluar ne çelje te ushtrimit” plus “Shtesat gjithesej” per ushtrimin minus “Pakesimet gjithesej” per ushtrimin). Ne shtesa per cdo rrjesht pasqyrohet amortizimi vjetor dhe ndonje shtese tjeter(kolona 4 = kolonat 2 +3). Ne paksime per cdo rrjesht kolona 8 = kolonat 5+6+7)

Vertikalisht : “Totali i pergjithshem” perfaqeson per cdo kolone shumen e rreshtave 1+2. Kjo shume pasqyron amortizimin e llogaritur per te gjitha llogarite e Aktiveve te Qendrueshme.

Gjendjet ne celje dhe ne mbyllje te ushtrimit per amortizimin e aktiveve te qendrushme duhet te jene detyrimisht te barabarte me te dhenat e evidentuara per to ne postet e amortizimit te aktiveve te Qendrushme ne aktiv te bilancit kontabel.

10. Pasqyra e levizjes se fondeve (Formati nr.6)

Ne kete pasqyre evidentohen gjendjet ne fillim, ndryshimet (shtesa apo paksim) dhe gjendjet ne fund te periudhes ushtrimore lidhur me fondet e veta te institucioneve (Grupi A i pasivit te bilancit kontabel).

Ne kolona, pervec emertimeve lidhur me numrin rendor, numrin e llogarise dhe pershkrimin paraqiten edhe gjendja ne celje (kolona 1), ndryshimet per periudhen (nga aktiviteti kolona 2, nga rivlersimi kolona 3) si dhe tepricat ne mbyllje (kolona 4= kolonat 1+2+3) per cdo rubrike dhe rresht.

Sipas rreshtave jepen numrat dhe emertimet e llogarive qe lidhen me fondet e veta te ndara;

- **Ne rubriken I** “Fondet baze”(rreshtin 1, si shume algjebrike e rreshtave 2 deri 8 te analizuara sipas llogarive dhe emertimeve). Brenda kesaj rubrike, ne kolona 2 perfaqeson llogarite e emertuara ku llogaria 1011 ne shenjen(+) ndersa llogarite 1012 deri 1016 me shenjen (-).
- **Ne rubriken II** “Diferencat nga rivlersimi” (rreshti 9 si shume algjebrike e rreshtave 10 e 11 te analizuara sipas llogarive dhe emertimeve). Brenda kesaj rubrike(ne rast se ka) ne kolonen 3 perfaqesohen sipas rastit(+ -) diferencat nga rivlersimi i aktiveve te qendrushme sipas dispozitave ligjore.
- **Ne rubriken III** perfaqesohet “Fondi i Brendshem”(rreshti 12 si shume algjebrike e rreshtave 13 deri 20 te analizuara sipas llogarive dhe emertimeve).
- **Ne rubriken III** perfaqesohet “Fondi i jashtem”(rreshti 21 si shume algjebrike e rreshtave 22 e 23 te analizuara sipas llogarive dhe emertimeve),

Ne rreshtin 24 jepet totali qe sipas kolonave perfaqeson shumen e rubrikave(I+II+III+IV) ose shumen e rreshtave (1+9+12+21).

Gjate evidentimit te informacionit ne kete pasqyre qelizat qe kane shenjen “x” nuk plotesohen.

Tepricat ne celje dhe ne mbyllje te llogarive respektive te fondeve duhet detyrimisht te jene te rakorduara me te dhenat e ketyre llogarive te pasqyruara ne grupin A te pasivit te bilancit kontabel.

11. Pasqyre mbi numrin e punonjeseve dhe fondin e pagave (Formati nr.7)

Kjo pasqyre eshte statistikore. Nepermjet saj sigurohet nje informacion, sipas kategorive te ndryshme qe pershkruhen, per numrin mesatar te punonjesve, ndryshimin e ketij numri gjate vitit, fondin e pagave, shperblimet suplementare dhe shperblimet e tjera, ndihmat shoqerore, kontributet per sigurimet dhe tatimet mbi te ardhurat personale.

Vertikalisht : Shuma e seciles kolone te rubrikes se kesaj pasqyre eshte shume e reshtave 1+2+3+4+5. Sqarimet per plotesimin tregohen ne fund te kesaj pasqyre ne menyre te detajuar. “Kontributi i sigurimeve shoqerore dhe shendetesore” llogaritet per shumen qe paguan punedhenesi per punemarresin dhe punemarresi ne organet e sigurimeve shoqerore e shendetesore. Totali i Fondit te pagave gjithesej (shuma bruto)” duhet te jete e barabarte me te dhenat respektive per shpenzimet ne pagat e punonjseve te perhershem e te perkohshem te evidentuara ne Pasqyren 1/1. “Tatimi mbi te ardhurat” perfaqeson pjesen e tatimit qe paguhet nga punemarresi per te ardhurat e tij personale, shume e cila eshte e perfshire ne fondin e pagave.

12. Per pyetesorin dhe shenimet shpjeguese(Formati nr.8)

Llogaria vjetore 2006 ka te shoqeruar ne format relacionin me te dhenat shpjeguse mbi bazen e pyetesorit ku hartuesit e llogartive vjetore duhet te japin pergjigjet e duhura. Rrregullat qe lidhen me pergjigjet per hartimin e nje llogarie sa me te sakte jane trajtuar me larte ne kete udhezim dhe shtrohen ne pyetsor e ne te dhenat shpjeguse.

Pavec pyetjeve pyetesori ka edhe rrjeshta per te relatuar problemet e tjera qe kane dale nga pregatitja e llogarive vjetore te vitit 2006 si per metodat e perdorura nga institucioni per vleresimin dhe paraqitjen ne bilanc te Aktiveve te Qendrushme dhe Qarkulluese, detyrimet dhe te drejtat afatgjate dhe afatshkurter te institucionit, e te tjera.

IV. DISA VECORI PER LLOGARITE VJETORE TE NJESIVE TE MENAXHIMIT / ZBATIMIT TE PROJEKTEVE E MARREVESHJEVE ME DONATORE TE HUAJ

Formati i llogarive vjetore 2006 te njesive te menaxhimit/zbatimit te projekteve e marreveshjeve me donatore te huaj eshte i njejte me ate qe miratohet me kete udhezim. Per pregatitjen e pasqyrave financiare ato zbatojne te njejtat procedura e kriteret te percaktuara ne rubrikat perkatese te ketij udhezimi me vecorite e meposhtme ;

- Keto njesi jane krijuar per menaxhimin apo zbatimin e projekteve te investimeve ne Vendin Tone, te financuara kryesisht me grante dhe kredi te huaja. Per kete qellim cdo shpenzim qe kryhet do te konsiderohet, deri ne nje rregullim tjetër, investim dhe cdo e ardhur qe merret nga aktiviteti sekondar(pervec interesave nga depozitat ne banke) perben dhe duhet te kaloje ne paksim te kostos se aktivitetit. Per pjesen qe perballon buxheti celja e fondeve kryhet ne artikujt buxhetore(230 e 231 apo ne artikujt buxhetore per shpenzime korrente – grupi 60).
- Kostoja e ngritjes dhe funksionimit te njesise gjate periudhave ushtrimore ne fund te vitit pasqyrohet ne grupin e llogarive 230 “Aktive te pa trupezuara ne proces” me kunderparti llogarine 782”Punime per investime ne ekonomi”. Gjate vitit shpenzimet pasqyrohen ne llogarite perkatese te klases 6, ndersa inventari qarkullues pasqyrohet ne llogarite perkatese te klases 3. Ne perfundim te projektit, kur investimi dorzohet i perfunduar tek institucionet perfituese, kostoja e administrimit te projektit kalon ne koston e objektit te perfunduar.

- Aktivitet e Qendrushme te trupezuara qe perdoren per nevoja te njesise evidentohen si te tilla me kete procedure;
 - Grantet dhe huate per keto investime regjistrohen ne debi te llogarive financiare (klasa 5) me kunderparti respektivisht kreditin e llogarive (105 e 106 per grantet e brendshme e te jashtme) dhe 17 "Huamarrje e huaj".
 - Transaksioni i blerjes pasqyrohet ne debi te llogarive te grupit 23 sipas natyres me kunderparti kreditin e llogarive financiare.
 - Berja hyrje e ketyre aktiveve te konsiderohen si vlera te marra ne perdorim duke i mbajtur ne llogarite jashte bilancit.
 - Ne fund te vitit behet kalimi i kesaj kostoje te aktiveve te blera(regjistruar ne grupin 23(psh.blerje kompjutra) ne koston direkte te projektit po ne grupin 23(por me analiza sipas llojit te investimit (psh konstruksionet e rrugeve).
- Kostoja direkte e investimit per projektet perkatese, gjate periudhes se zbatimit te tij pasqyrohet ne analizat respektive te llogarive te grupit 23"Aktive te qendrushme te trupezuara ne proces" me kunder parti kreditin e llogarite te detyrimeve apo dhe llogarite financiare. Fondet e perdorura per krijimin e tyre jane evidentuar ne debi te llogarive financiare me kunderparti kreditin e llogarive respektive 105,106,16,17.
Me perfundimin dhe dorzimin e investimit llogarite e mesiperme mbyllen. Grupi i llogarive 17"Huamarrje e huaj" ne njesite e menaxhimit te projekteve perdoret vetem per evidentimin e prejardhjes se fondeve(ne kredi) dhe mbyllet me objektet e dorzuara (ne debi). Pra ne njesi nuk ka natyren e mirfillte te evidentimit te principialit dhe shlyerjes se huase.Kjo pasi huaja evidentohet ne llogarine e Qeverise ne Qender ne Ministrine e Financave.
- Lidhur me etapat per pregatitjen, mbylljen e llogarive dhe hartimin e pasqyrave financiare, procedura po thuhet eshte e njejte por me keto vecori;
 - Njesite e menaxhimit/zbatimit te projekteve te huaja qe veprojne me sistem te pjeseshem thesari dhe qe kane terhequr fonde nga llogaria e thesarit per ne llogarine ne banke me teper se sa kane perdorur duhet te procedojne per derdhjen e tyre ne buxhet me veprimin kontabel; Debi 476"te ardhura te caktuara per t'u perdorur" ne kredi te 512"llogari ne banke" (ne se konferma permban daten 31/12/2006) ose Debi 476 ne kredi 4341"Mardhenie me shtetin kreditor" (ne se nuk jane derdhur brenda vitit ushtrimor).
 - Ne fund te periudhes ushtrimore percaktohet shuma e shpenzimeve korrente qe duhet te kalojne ne seksionin e investimeve. Kjo shume duhet te jete e barabarte me totalin e shpenzimeve te klases 6 minus te ardhurat sekondare (ne llogarite e grupit 71) minus grantet korrente(ne grupin e llogarise 72) minus te ardhurat financiare(pa interesat). Per kete vlere behet artikulli kontabel ne debi te llogarise 230"Aktive te qendrushme te pa trupezuara ne proces" me kunderparti kreditin e llogarise 782"Investime ne ekonomi".
 - Percaktohen e regjistrohen mardheniet me shtetin lidhur me te ardhurat qe i perkasin buxhetit per interesat e perfituara qe i perkasin llogarive bankare (ne rast se nuk jane derdhur gjate vitit)

me veprimin debi llogaria 8420 "Derdhje te ardhura ne buxhet" ne kredi te llogarise 4341 "mardhenie me shtetin kreditor".

- Mbas kryerjes se gjithe procedures se mbylljes se llogarive, llogaria 85"Rezultate nga operacionet e funksionimit" normalisht duhet te kete tepricen zero. Ne rast te kundert te jepen shkaqet ne te dhenat shpejguese qe jane pjese e raportimit vjetor.

➤ Njesite e menaxhimit / zbatimit te projekteve krahas pasqyrave financiare sipas formatit te miratuar, llogaridhenin vjetore ta shoqerojne edhe me nje liste progresive te projekteve me kete permbajtje sipas kolonave; Pershkrimi i projekteve objekt investimi, Data e fillimit te projektit, Data e mbarimit ose ne proces te projektit, Shuma e projektit ne mije leke, te ndare sipas donatoreve, Institucioni perfitues i investimit, Data e dorzimit te investimit tek perfitusi.

✚ Formati bashkelidhur i Llogarise vjetore 2006 miratohet me kete udhezim. Struktura e llogarive dhe ndryshimet e saj te mbeten kopetence e Drejtorit te Pergjithshem te Thesarit.

✚ Udhezimi nr. 2, date 29.01.2002 i Ministrit te Financave "Per pergatitjen e llogarive vjetore te vitit 2001 te institucioneve buxhetore nacionale dhe lokale", Udhezimi nr. 19 date 24.12.2003 i Ministrit te Financave "Per pregatitjen e pasqyrave financiare vjetore te institucioneve qendrore, organeve te pushtetit vendor dhe njesive qe varen prej tyre", Udhezimi nr. 20 date 24.12.2003 i Ministrit te Financave " per pregatitjen e pasqyrave financiare vjetore te njesive te menaxhimit/zbatimit te projekteve dhe marreveshjeve me donatore te huaj" si dhe cdo udhezim tjeter qe bije ne kundersizim me kete udhezim, shfuqizohen.

✚ Ky udhezim hyn ne fuqi menjehere.

Ridvan BODE

MINISTER

Konceptoi; Enver KALEMASI, Pergjegjes Sektori

Konfirmoi; Ylber BEZO, Drejtor

Konfirmoi; Nezir HALDEDA, Drejtor I Pergjithshem